

V E N D I M
Nr.234, datë 22.5.1999

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.301,
DATE 14.6.1993 "PËR MASAT PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7698, DATË 15.4.1993
"PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE ISH-PRONARËVE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", me propozimin e Ministrisë së Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.301, datë 14.6.1993 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet si vijon:

"a) Në të gjitha rrethet e vendit, si dhe në Bashkinë e Tiranës, komisionet e kthimit dhe të kompensimit të pronave të ish-pronarëve përbëhen nga 5 veta, si më poshtë:

1. Kryetari i komisionit- Sekretari i këshillit të rethit
2. Nënkryetari- Jurist ose inxhinier, specialist me arsim të lartë në fushën e ndërtimit
3. Specialist- Urbanist, inxhinier, specialist me arsim të lartë i fushës së ndërtimit
4. Specialist- Inxhinier ndërtimi, ekonomist ose specialist me arsim të lartë në fushën e

bujqësisë

5. Specialist- Arkivist, sekretar, daktilografist, me arsim të lartë

b) Emërimi dhe largimi nga puna i nënkryetarit dhe anëtarëve të komisionit të kthimit dhe të kompensimit të pronave ish-pronarëve do të bëhet me propozimin e sekretarit të këshillit të rethit ose të sekretarit të Këshillit të Bashkisë së Tiranës dhe me miratimin e këshillit të rethit ose Këshillit të Bashkisë së Tiranës.

Propozimet, që paraqiten për miratim nga sekretarët e këshillave të rretheve ose nga sekretari i Këshillit të Bashkisë së Tiranës, do të jenë propozime alternative me dy kandidatë.

Në rast se këshillat e rretheve ose Këshilli i Bashkisë së Tiranës nuk bien dakord me propozimet e bëra nga sekretarët e këshillave të rretheve ose nga sekretari i Këshillit të Bashkisë së Tiranës, propozimet i paraqiten për miratim Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve, i cili merr vendimin për emërimin ose jo të kandidaturave, që i paraqiten për miratim.

Nëse edhe nga Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe i Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve nuk vendoset për emërimin e kandidaturave të paraqitura, atëherë procedura e emërimit fillon nga e para, me kandidatura alternative, të reja.

c) Komisionet kanë këto detyra e të drejta themelore:

- U konfirmojnë të drejtën e pronësisë ish-pronarëve, duke lëshuar dokumenti përkatës për njohjen, masën dhe mënyrat e kthimit ose të kompensimit të saj.

- Kontrollonjë vërtetësinë e dokumentacionit, që paraqesin ish-pronarët dhe e ballafaqojnë atë me aktet ligjore e nënligjore, që kanë shërbyer për shtetëzimin, konfiskimin ose shpronësimin e ish-pronarëve.

- Verifikojnë ose llogarisin detyrimet financiare që lindin ndërmjet shtetasve dhe shtetit, në procesin e kthimit ose të kompensimit të pronave dhe urdhërojnë organet financiare, në rreth e në bashki, të ekzekutojnë plotësimin e tyre, në përputhje me vendimin që ka marrë komisioni.

- Ish-pronari, për çdo kërkesë të paraqitur pranë komisionit, paguan një tarifë shërbimi prej 2 000 (dy mijë) lekësh, e cila do të përdoret për të mbuluar një pjesë të shpenzimeve që bëhen në këtë proces.

- Miratojnë listën e ekspertëve, të cilët vlerësojnë vlerën e shpenzimeve të bëra në objekt, për ndryshime në strukturë, shtesa anësore, shtesa kati etj, si dhe vlerën e dëmit të shkaktuar nga

keqpërdorimi i objektit.

- Urdhërojnë institucionin, që ka në administrim pronën shtetërore, të paraqesë dokumentet, që komisioni i gjykon të nevojshme.

- Në përputhje me ligjin e në bazë të dokumentacionit përkatës, përcaktojnë rastet kur ish-pronarët nuk përfitojnë kthimin ose kompensimin e pronës.

- Vënë në dukje pretendimet e ish-pronarëve, që nuk kanë gjetur zgjidhje në këtë ligj, dhe ia paraqesin Komitetit Shtetëror të kthimit dhe të Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve.

- Për afatet e shqyrtimit të dokumenteve të paraqitura nga ish-pronarët, marrjen e vendimeve, dërgimin e të dhënave, në bazë të kërkesës së Komisionit Shtetëror të Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve, ky i fundit nxjerr udhëzime të veçanta, që janë të detyrueshme për zbatim nga komisionet e kthimit të pronave ish-pronarëve në rrethe.

Kryetari i Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve u propozon organeve përkatëse masa disiplinore e administrative për personat përgjegjës, për moskryerjen e detyrave të caktuara nga komisionet.

ç) Nënkyetari dhe dy nga anëtarët e komisionit, nga të cilët njëri do të jetë arkivist, sekretar, daktilogrfist, do të punojnë me shkëputje nga puna.

- Në Komisionin e Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave, pranë Bashkisë së Tiranës, të gjithë anëtarët do të punojnë me shkëputje nga puna.

- Anëtarët e komisionit, përveç pagesës, marrin edhe një shpërblim plotësues mujor.

- Kryetari, nënkryetari dhe anëtarët e komisionit, pa shkëputje nga puna, marrin shpërblim plotësues mujor në masën 60 për qind të pagës, sipas funksionit të secilit anëtar, por jo më shumë se 4 000 (katër mijë) lekë.

- Pagat e anëtarëve të komisionit, me shkëputje nga puna, caktohen në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.393, datë 3.9.1992.

d) Gjatë periudhës që punojnë si anëtarë të komisioneve të pronave, personave të përmendur në paragrafin e mësipërm, do t'u ruhet vendi i punës deri në përfundimin e këtij procesi."

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko